

## REZOLUTË

### PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË PROKURORISË PËR VITIN 2019

#### **Kuvendi i Shqipërisë,**

Duke vlerësuar rolin e prokurorisë në parandalimin dhe luftimin e kriminalitetit në vend, në zbatimin e rekomandimeve parësore të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit;

Duke vlerësuar rolin e prokurorisë në efektivitetin e ndjekjes penale, cilësinë e përfaqësimit të akuzës në gjyq dhe në efektivitetin e zbatimit të ligjeve, që ngarkojnë me kompetenca edhe këtë institucion;

Duke mbajtur parasysh rolin e Prokurorit të Përgjithshëm në nxjerrjen e udhëzimeve të përgjithshme për prokurorët e prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm, për oficerët e Policisë Gjyqësore, si dhe për mbikëqyrjen e zbatimit të tyre;

Duke ritheksuar përgjegjësitë e prokurorisë në zbatimin me sukses të reformës në drejtësinë penale;

Duke vlerësuar kontributin e dhënë mes opinionëve dhe sugjerimeve në procesin e hartimit të legjislationit dhe/ose përmirësimit të tij;

Duke ritheksuar rëndësinë e bashkëpunimit të Prokurorit të Përgjithshëm me organet ekzekutive ligjzbatuese, Kuvendin e Shqipërisë dhe organet e tjera homologe dhe organizatat e asistencës dhe ndihmës në raport me prokurorinë;

Duke nënvizuar rëndësinë e bashkëpunimit të Prokurorit të Përgjithshëm dhe drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme në luftimin e pastrimit të parave të korrupsionit, krimit të organizuar dhe terrorizmit;

Duke ritheksuar detyrimin e prokurorisë për të siguruar një procedim të drejtë, të barabartë, të rregullt ligjor, për të mbrojtur liritë personale dhe të drejtat e njeriut, për të mbrojtur e për të forcuar rendin juridik dhe për të zbatuar Kushtetutën dhe ligjet në fuqi;

Duke mbajtur parasysh rëndësinë e mbledhjes, përpunimit dhe publikimit të statistikave, si bazë e nevojshme për të analizuar kriminalitetin, format dhe prirjet e tij, si dhe bazë shkencore për të hartuar, zbatuar, ndryshuar dhe vlerësuar politikën penale dhe efektivitetin e institucioneve të drejtësisë penale;

Duke vlerësuar rëndësinë e raportimit të Prokurorit të Përgjithshëm në Kuvendin e Shqipërisë për gjendjen e kriminalitetit, zbatimin e rekomandimeve parësore të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit dhe për efektivitetin e ndjekjes penale;

Të ndërgjegjshëm për rolin e prokurorisë në përmbushjen e detyrimeve në kuadër të integritetit evropian;

Duke risjellë në vëmendje vendimin nr. 134/2018 të Kuvendit të Shqipërisë për miratimin e Manualit të Monitorimit Vjetor dhe Periodik të institucioneve të pavarura kushtetuese ose të krijuara me ligj;

Duke mbajtur parasysh rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë, datë 20.6.2019 “Për vlerësimin e veprimtarisë së prokurorisë për vitin 2018”;

**Bazuar në analizën e të dhënave për kriminalitetin në vend gjatë vitit 2019, të referuara në raportin e paraqitur, Kuvendi i Shqipërisë konstaton se gjatë vitit 2019:**

- Koeficienti i kriminalitetit, sipas procedimeve penale të regjistruara, është 1072 për 100.000 banorë, me ulje (1094) krahasuar me vitin 2018.

- Vjedhja e pasurisë (31,50 %) pasuar nga veprat penale kundër rendit dhe sigurisë publike (23,85%), dhe veprat penale që cenojnë regjimin juridik të tokës (6,22 %) zënë vendin e parë në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori gjatë vitit 2019.

- Grupet e tjera të veprave penale zënë një përqindje më të vogël në numrin e përgjithshëm të procedimeve penale të regjistruara, si: krimet kundër jetës të kryera me dashje (1,41 %); krimet kundër shëndetit të kryera me dashje (2,94 %); veprat penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes (4,06 %); veprat penale e mashtrimet (2,43 %); shkatërrimi i pronës (4,10 %); veprat penale në lidhje me taksat dhe tatimet (1,35 %); falsifikimi i dokumenteve (3,87 %); krimet

kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga shtetasit (2,08%); krimet kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë ose në shërbim publik (3,25 %); veprat penale kundër sekretit dhe kufijve shtetërorë (4,75 %) dhe veprat penale kundër drejtësisë (2,22 %).

- Për sa i përket gjinisë, raporti i të pandehurve meshkuj-femra ka njohur ulje të lehtë të procedimit penal të femrave nga viti në vit. Në vitin 2019 raporti i të pandehurve sipas gjinisë ishte 94,25% meshkuj dhe 5,75% femra.

- Lidhur me efektivitetin e ndjekjes penale, në krahasim me vitin 2018, rezulton ulje e numrit të çështjeve të përfunduara me 7,95% të çështjeve të dërguara në gjykatë me 11,82%; numri i të pandehurve dërguar në gjykatë është ulur me 9,29%.

- Numri i çështjeve të pushuara është ulur me 12,53% dhe atyre të pezulluara është ulur me 7,30% në krahasim me vitin 2018.

- Prokuroria ka shpallur në kërkim ndërkombëtar 235 shtetas dhe ka kërkuar që Zyra Qendrore Kombëtare Interpol Tiranë të procedojë me heqjen e 172 subjekteve nga listat e kërkimit ndërkombëtar. Prokuroria e Përgjithshme ka trajtuar 651 kërkesa të ndryshme të ardhura nga autoritetet gjyqësore vendase e ato të huaja.

- Janë ekzekutuar 2714 vendime për përgjime të autorizuara nga gjykata në hetimet paraprake, të zbatuara për 717 procedime penale, nga të cilat 141 procedime penale i përkasin Prokurorisë për Krime të Rënda. Është mundësuar interceptimi për 5062 persona të dyshuar si të përfshirë në vepra penale.

#### **Kuvendi i Shqipërisë shqyrtoi:**

Rezolutën e tij të datës 20.6.2019 “Për vlerësimin e veprimtarisë së organit të prokurorisë për vitin 2017”, në përmbushje të detyrimit të parashikuar në lidhjen 3, pika 5, të vendimit të Kuvendit nr. 49/2017 “Për krijimin e mekanizmit për monitorimin sistematik të ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj”;

Rekomandimet e Këshillit të Ministrave “Për luftën kundër kriminalitetit për vitin 2019”, të miratuara në zbatim të nenit 103, pika 3, të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”;

Raportin e ministres së Drejtësisë për mënyrën e zbatimit nga organi i prokurorisë së rekomandimeve parësore të dhëna nga Këshilli i Ministrave në luftën kundër kriminalitetit, në zbatim të neni 103, pika 5, të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë.

#### **Bazuar në analizën e raportit, të rekomandimeve të Këshillit të Ministrave dhe në raportimin e ministres së Drejtësisë rezulton se:**

- Prokuroria e Përgjithshme ka vijuar punën për forcimin e luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar nëpërmjet zbatimit më të mirë të procedurave të hetimit proaktiv dhe përdorimit në kufijtë e ligjit të teknikave speciale të hetimit, si dhe ka marrë masa për transferimin e çështjeve në Prokurorinë e Posaçme Kundër Krimit të Organizuar. Në krahasim me vitin 2018, numri i hetimeve proaktive është rritur, por ende është në nivele të ulta; numri i çështjeve të proceduara dhe dërguar në gjykatë vijon të jetë i ulët; politika penale është ashpërsuar dhe numri i personave të dërguar në gjykatë është rritur.

- Ka vijuar mbikëqyrja e zbatimit të udhëzimit të përgjithshëm nr.6/2018 “Për hetimin pasuror, sekuestrimin dhe konfiskimin e produkteve të veprës penale”. Hetimet pasurore për të ardhurat kriminale nga jashtë vendit janë rritur 40% krahasuar me vitin 2018. Për veprat penale të pastrimit të parave nga krimi i organizuar, ka pasur ulje të procedimeve të regjistruara, por rritje të numrit të çështjeve dhe të personave të dërguar për gjykim.

- Është rritur bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë dhe autoritetet gjyqësore të huaja dhe Prokuroria e Përgjithshme po bashkëpunon me Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe Shkollën e Magjistraturës;

- Është hartuar projekti i udhëzimit në zbatim të rekomandimit për hartimin e udhëzimeve të nevojshme për zbatimin e rekomandimeve parësore të Këshillit të Ministrave për luftimin e kriminalitetit për vitin 2019, por nuk është miratuar ende;

- Hartimi i kalendarit të trajnimit të oficerëve të Policisë Gjyqësore është në proces;

- U përgatit dhe u miratua udhëzimi i përgjithshëm për garantimin e pavarësisë së prokurorit, marrëdhëniet e tij me drejtuesit e prokurorisë dhe informimi në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm;

- Miratimi i rregullave standarde për organizimin dhe funksionimin e prokurorive me juridiksion të përgjithshëm, që sigurojnë efikasitet në organizimin, drejtimin dhe kontrollin e punës në çdo prokurori është në proces;

- Rekomandimet e adresuara nga Komisioni i Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e zbatimit të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” janë vlerësuar;

- Është ngritur zyra e zhvillimit për drejtësinë penale për të miturit dhe janë përgatitur tri dokumente, akte për të drejtat e të miturit në konflikt me ligjin dhe të drejtat e të miturit viktimë e veprës penale;

- Lidhur me veprën penale të dhunës në familje, konstatohet një rënie e numrit të çështjeve të regjistruara si dhe nuk konstatohet ashpërsimi i politikës penale;

- Janë punësuar koordinatorët që asistojnë subjektet me status të veçantë, përfshi dhe viktimat akuzuese;

- Janë miratuar udhëzimet e përgjithshme për kuptimin dhe zbatimin në praktikë të instituteve procedurale të reja, si: urdhri penal, marrëveshja e fajësisë, gjykimi i drejtpërdrejtë, por zbatimi i tyre është ende i ulët. Ka një rritje të zbatimit të dënimeve alternative, por gjykimi i drejtpërdrejtë, çështjet për të cilat është kërkuar miratimi i urdhrit penal dhe marrëveshjes vijnë të mbeten pak të zbatuara.

- Mbledhja dhe përpunimi i statistikave të ndjekjes penale dhe të kriminalitetit, sipas standardeve ndërkombëtare nuk është mundur ende;

- U përgatit dhe u miratua udhëzimi i përgjithshëm për marrëdhëniet me publikun në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm, duke mundur komunikimin me publikun dhe respektimin e parimeve të parashikuara në legjislacionin në fuqi për ruajtjen e sekretit hetimor;

- Është në proces realizimi, hartimi dhe nxjerrja e udhëzimeve për zbatimin e ligjit nr.138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”;

- Me miratimin e ligjit për Policinë Gjyqësore, vijoi puna për të siguruar bashkëpunimin, koordinimin dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë me institucionet dhe agjencitë ligjzbatuese, që kanë shërbime të Policisë Gjyqësore;

- Janë nxjerrë 10 udhëzime të përgjithshme, përfshirë edhe ato për garantimin e të drejtave e lirive kushtetuese e ligjore të shtetasve në procesin penal.

### **Bazuar sa më sipër, për vitin 2020 Kuvendi i Shqipërisë kërkon nga Prokuroria e Republikës së Shqipërisë:**

1. Rritjen e mëtejshme të efektivitetit në luftën kundër kriminalitetit dhe forcimin e koordinimit me Prokurorinë e Posaçme të Luftës kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit për rritjen e cilësisë së hetimeve dhe ndjekjes penale.

2. Të rrisë efektivitetin e bashkëpunimit ndërinstitucional me agjencitë e tjera për luftimin e pastrimit të produkteve dhe krimit financiar, të forcojë kapacitetet profesionale për hetimet pasurore, hetimet proaktive të pastrimit të parave, sekuestrimit dhe konfiskimit të tyre me qëllim zbulimin, identifikimin dhe sekuestrimin/konfiskimin e pasurive që rrjedhin nga veprimtaria kriminale, si dhe për një politikë penale efektive në këtë fushë.

3. Të vijojë punën për rritjen e aksesit të përdorimit të të dhënave në databazet shtetërore, sidomos në atë të noterisë dhe të shërbimit të përmbartimit gjyqësor dhe të informojë Kuvendin

në lidhje me përmbushjen e këtij rekomandimi dhe nevojat për adresimin e vështirësive të hasura, nëse do të ketë të tilla.

4. Të miratojë rregullat standarde për organizimin dhe funksionimin e prokurorive me juridiksion të përgjithshëm, me qëllim që të sigurojnë efikasitet në organizimin, drejtimin dhe kontrollin e punës në çdo prokurori.

5. Të forcojë bashkëpunimin me Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe Shkollën e Magjistraturës për të plotësuar nevojat për prokurorë dhe sigurimin e mbarëvajtjes së punës në të gjitha prokuroritë e rretheve gjyqësore.

6. Të miratojë udhëzimin e standardizuar për zbatimin e ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

7. Të nxisë, bashkëpunojë dhe kontribuojë në miratimin sa më shpejt nga ana e Komisionit të Policisë Gjyqësore të sistemit të vlerësimit të oficerëve të Policisë Gjyqësore.

8. Të rrisë bashkëpunimin me Ministrinë e Drejtësisë, drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit, Policinë e Shtetit, gjykatat dhe institucionet e tjera shtetërore për të filluar krijimin e sistemit të unifikuar të mbledhjes, përpunimit dhe publikimit të statistikave të kriminalitetit, bazuar në standardet ndërkombëtare.

9. Të vlerësojë nxjerrjen e një udhëzimi të veçantë me karakter të përgjithshëm me qëllim unifikimin e politikës penale dhe të hetimit të veprave penale në familje, kundër fëmijëve dhe grave dhe krimeve me motive të urrejtjes, bazuar në standardet me të mira ndërkombëtare të fushës, si dhe për mbledhjen, përpunimin e të dhënave për këto vepra penale bazuar në standardet ndërkombëtare të fushës.

10. T’u kushtohet vëmendje e veçantë viktimave dhe mbrojtjes së tyre gjatë procedimit penal deri në përfundimin e procesit gjyqësor.

11. Zbatimi i urdhrat penal, marrëveshja e fajësisë, gjykimi i drejtpërdrejtë duhet të vijojë të njihen dhe të zbatohen më mirë nga prokurorët. Prokuroria duhet t’i kushtojë më shumë kujdes zbatimit të dënimeve alternative dhe respektimit të procedurave të ekzekutimit të vendimeve penale, të forcojë bashkëpunimin me Shërbimin e Provës dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve gjatë fazës së procedimit penal dhe ekzekutimit të vendimeve penale.

12. Të miratojë udhëzimin për zbatimin e rekomandimeve parësore të Këshillit të Ministrave për luftimin e kriminalitetit.

13. Raporti i Prokurorit të Përgjithshëm në Kuvendin e Shqipërisë duhet të bazohet në manualin e raportimit, i miratuar me vendimin nr. 134/2018 të Kuvendit të Shqipërisë, me fokus të veçantë pasqyrimin e detajuar të gjendjes së kriminalitetit, tendencat e tij, efektivitetin e ndjekjes penale, politikat penale, faktorët kriminogjenë të evidentuar gjatë hetimit penal.

**KRYETAR  
Gramoz Ruçi**

Miratuar në datën 18.6.2020.